



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

VENDIM

Nr. 82 dt. 09.10.2014

Në mbështetje të nenit 47, të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 09.10.2014, pasi shqyrtoi projektin e diskutuar më parë në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

VENDOSI:

1. Miratimin në parim të projekt-idesë “Përgatitja e projektit dhe dosjes së tenderit në lidhje me punimet e Restaurimit në qytetet e Trashëgimisë Historike, Vendodhja – Elbasan, Berat, Vlorë, Burrel, Krujë dhe Shkodër”, me vërejtjet:
 - Elbasan:
 - Sistemi i kullimit të ujërave atmosferikë në kuneta në rrugët Saveta Mishta, Tanjar Guranjaku dhe Bardhyl Popa, të jetë sipas aksit të rrugës.
 - Në rrugën Kol Papajani miratohet varianti i shtrimit tërthor.
 - Në rrethimin e bazilikës së Bezistanit, miratohet varianti i portës me hark.
 - Berat:
 - Motivet anësore të rrugës Mihal Komneno të jenë të drejtë dhe jo me ngjyrë të bardhë për të mos krijuar kontrast të fortë.
 - Miratohet varianti i parë i sistemimit të terrenit me mobilim me stol rrethor në hyrjen e Belvederes.
 - Vlorë:
 - Miratohet varianti i shtrimit në rrugën Kostandin Kristoforidhi, me gurë gri dhe aksin e rrugës të theksuar me gur të bardhë.
 - Paneli shpjegues para objekteve monument kulture të jetë sa më i thjeshtë.

- Burrel:
 - Vendimmarrja e variantit të propozuar për rehabilitimin e sheshit para Bashkisë Burrel të bëhet nga pushteti lokal.

 - Krujë:
 - Për vendosjen e tualeteve miratohet varianti 1 i propozuar (veshje me dru).
 - Për shtrimin e rrugës Vrana Konti, miratohet varianti 1 i propozuar, me breza tërthorë.

 - Shkodër:
 - Rehabilitimi i sheshit para kishës Françeskane të realizohet pa rrezet e propozuara në projekt.
2. Pas reflektimit të vërejtjeve projekti i zbatimit të shqyrtohet nga IMK dhe KKR.
 3. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
 4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.
 5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI



SEKRETAR I KKR

ARTA DOLLANI